

VENDIM
Nr.83, datë 15.11.2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI ORGANIZIMIN E KLERINGUT TË ÇEQEVE NË LEKË NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 4 shkronja “dh” të nenit 12, të nenit 21 dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 26 pika 3 shkronja “ç” dhe d” të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi organizimin e kleringut të çeqeve në lekë në Bankën e Shqipërisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave me zbatimin e këtij vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.87, datë 27.8.1999 “Për organizimin e shërbimit të kleringut në Bankën e Shqipërisë”.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
MBI ORGANIZIMIN E KLERINGUT TË ÇEQEVE NË LEKË NË BANKËN E SHQIPËRISË

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të kleringut të çeqeve në lekë në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në përputhje dhe në zbatim:

- a) të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 1 pika 4 shkronja “b”, nenit 3 pika 2 dhe pika 4, shkronja “dh”, nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 21;
- b) të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nenit 26 pika 3 shkronjat “ç” dhe “d”;
- c) të ligjit nr.3702, datë 8.7.1963 “Për çekun”, i ndryshuar;
- d) të rregullores “Për sistemin dhe instrumentet e pagesave”, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) Klering i çeqeve – është procesi i transmetimit, rakordimit dhe/ose i konfirmimit të çeqeve përpara shlyerjes, që përfshin netimin e instruksioneve dhe përcaktimin e pozicioneve përfundimtare për shlyerje.

b) Seancë kleringu—është periudha kohore brenda të cilës kryhet shkëmbimi i informacionit mbi çeqet ndërmjet pjesëmarrësve në klering.

c) Pjesëmarrës—janë bankat e anëtarësuara në shërbimin e kleringut dhe Banka e Shqipërisë.

d) Bankë—është çdo subjekt i licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer veprimtari bankare dhe financiare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

e) Bankë dërguese—është banka që prezanton çeqet në seancën e kleringut, në adresë të bankës që i ka lëshuar.

f) Bankë marrëse—është banka që merr çeqet e prezantuara në seancën e kleringut nga banka dërguese.

g) Netimi—është procesi i kompensimit të një numri të madh detyrimesh individuale, duke i reduktuar ato në një numër më të vogël detyrimesh.

h) Instruksioni i shlyerjes neto—është një instruksion shumëpalësh, i dërguar nga drejtuesi i seancës në sistemin AIPS në fund të një seance kleringu të çeqeve në lekë (formulari 4, pjesë e kësaj rregulloreje), në të cilin listohen pozicionet neto debitore apo kreditore të çdo pjesëmarrësi në fund të seancës së kleringut, dhe që përdoret nga AIPS për kryerjen e shlyerjes. Pozicionet neto debitore ose kreditore dalin si rezultat i diferencës mes shumës së çeqeve të marra dhe atyre të dërguara.

i) AIPS—është sistemi i shlyerjes bruto në kohë reale i administruar nga Banka e Shqipërisë, në të cilin shlyhen sistematikisht pagesa të rëndësishme në lekë brenda territorit të Shqipërisë, pa vonesë (në kohë reale) dhe në mënyrë individuale (bruto).

j) Shlyerje—është një tërësi transfertash parash midis llogarive të shlyerjeve të pjesëmarrësve në sistemin AIPS, të iniciuara kur drejtuesi i seancës së kleringut të çeqeve dërgon një instruksion shlyerjeje neto në AIPS, menjëherë pas përfundimit të një seance kleringu.

k) Dublikata—është kopja e çekut, e cila zëvendëson çekun e paraqitur fillimisht në klering, që ka humbur përpara pagesës përfundimtare, dhe të cilën banka lejohet ta lëshojë të shoqëruar nga një deklaratë e nënshkruar nga një firmë e autorizuar e kategorisë së parë të kësaj banke.

l) Dokument kontabël—është bashkësia e kopjeve të formularëve 2, 3 dhe 4, pjesë e kësaj rregulloreje, që lidhen në datën kontabël.

KREU II ORGANIZIMI I KLERINGUT TË ÇEQEVE NË LEKË

Neni 4 Seanca e kleringut

1. Seanca e kleringut zhvillohet çdo ditë-punë, në orën 13:00, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, në Tiranë.
2. Gjatë seancës së kleringut të çeqeve, pjesëmarrësit shkëmbejnë informacion mbi çeqet në lekë.
3. Rezultati i seancës së kleringut të çeqeve llogaritet në bazë multilaterale neto dhe paraqitet në formularin e instruksionit të shlyerjes neto (formulari 4, pjesë e kësaj rregulloreje).
4. Drejtimi i seancës së kleringut kryhet nga një prej specialistëve të Zyrës së Kleringut pranë Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë.

Neni 5 Pjesëmarrja në seancën e kleringut

1. Çdo bankë paraqet pranë Bankës së Shqipërisë formularin e kërkesës për anëtarësim në klering (formulari 1, pjesë e kësaj rregulloreje). Në kërkesë përcaktohet data e fillimit të pjesëmarrjes dhe emrat e përfaqësuesve të autorizuar për përfaqësim në seancat e kleringut.
2. Çdo bankë përfaqësohet në seancën e kleringut nga një përfaqësues i autorizuar prej saj për këtë qëllim.
3. Me qëllim marrjen e dokumenteve nga pjesëmarrësit e tjerë, banka përfaqësohet në seancën e kleringut edhe në rastet kur nuk ka çeqe për të dërguar te këta pjesëmarrës.
4. Çdo bankë i komunikon me shkrim të gjithë pjesëmarrësve të tjerë:
 - a) emrat e personave të autorizuar prej saj, për përfaqësimin në seancat e kleringut;
 - b) nënshkrimet e autorizuar për të kryer veprime në klering;
 - c) shfuqizimin e autorizimit ose ndryshimin e personave të autorizuar, si dhe datën në të cilën këto ndryshime hyjnë në fuqi.

Neni 6

Përgatitja e dokumenteve para seancës

Banka dërguese, përpara përfaqësimit në seancën e kliringut, ndjek procedurat e mëposhtme për përgatitjen e dokumentacionit:

1. Kontrollon dhe vulos çeqet e paraqitura me emrin e saj.
2. Në rast të konstatimit të humbjes së çekut, paraqet dublikatën përkatëse, të shoqëruar nga një deklaratë e nënshkruar nga një firmë e autorizuar e kategorisë së parë të kësaj banke.
3. Vendos çeqet e paraqitura në zarfe të veçanta, sipas llojit të çekut, bankar ose personal, dhe sipas bankës marrëse.
4. Shënon në pjesën e pasme të çdo zarfi numrin dhe shumën e çeqeve të mbyllura në të.
5. Plotëson formularin për dërgimin e çeqeve në lekë në kliring (formulari 2, pjesë e kësaj rregulloreje) dhe e firmos atë nga dy persona të autorizuar (nënshkrimet e autorizuar).

Neni 7

Procedura e kliringut të çeqeve në lekë

1. Përfaqësuesit e autorizuar të pjesëmarrësve, në seancën e kliringut të çeqeve:
 - a) shkëmbejnë midis tyre zarfet me çeqe;
 - b) plotësojnë formularin përkatës për kliringun e çeqeve (formulari 3, pjesë e kësaj rregulloreje) përkatësisht sipas llojit të çekut, bankar ose personal, me numrin dhe shumën e çeqeve të sjella, në bazë të informacionit të shkruar në pjesën e pasme të zarfeve;
 - c) llogarisin dhe shkruajnë shumën neto për të cilën debitohet ose kreditohet llogaria rrjedhëse e tyre në Bankën e Shqipërisë;
 - d) nënshkruajnë dhe dorëzojnë formularin 3, të plotësuar në përputhje me shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, te drejtuesi i seancës së kliringut.
2. Drejtuesi i seancës së kliringut, në seancën e kliringut të çeqeve:
 - a) plotëson formularin e instruksionit të shlyerjes neto për të gjithë pjesëmarrësit, sipas llojit të çekut, bankar ose personal (formulari 4, pjesë e kësaj rregulloreje);
 - b) kontrollon nëse shuma e veprimeve të hedhura në formularin 4 është e barabartë me zero;
 - c) në rast se shuma e veprimeve të hedhura në formularin 4 nuk është e barabartë me zero, evidenton dhe korrigjon gabimin në praninë e përfaqësuesve të pjesëmarrësve;
 - d) njeh përfaqësuesit e pjesëmarrësve me rezultatet neto të seancës së kliringut;
 - e) deklaron të mbyllur seancën e kliringut të çeqeve dhe më pas nënshkruan formularin 4.

Neni 8

Shlyerja e rezultatit të seancës së kliringut

Drejtuesi i seancës së kliringut, pas deklarimit të mbyllur të seancës:

1. dorëzon instruksionin e shlyerjes neto, me rezultatit të seancës së kliringut në Zyrën e Shlyerjeve (AIPS) të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave, për të vazhduar sipas procedurave dhe orareve të shlyerjes së këtij sistemi;
2. përgatit dhe shpërndan dokumentet kontabël, nga të cilat një kopje e dërgon për t'u lidhur në dokumentet e datës kontabël në Sektorin e Kontabilitetit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave dhe një kopje ia dërgon bankave pjesëmarrëse në procedurën përkatëse të kliringut, nëpërmjet postës kontabël.

Neni 9

Verifikimi dhe kthimi i çeqeve

1. Afati i verifikimit të çeqeve personale nga banka marrëse është 3 ditë-punë. Me kalimin e këtij afati, çeqet personale konsiderohen të konfirmuara.
2. Mosmarrëveshjet e lindura nga moszbatimi i afatit të përcaktuar për verifikimin e çekut, prej njërit prej pjesëmarrësve, zgjidhen jashtë seancës së kliringut, me mirëkuptim midis pjesëmarrësve

përkatës.

3. Çeqet e gatshme për t'u marrë nga banka marrëse, të cilat nuk merren prej tyre në ditën e zhvillimit të seancës së kleringut, për qëllime rregullimi dhe kthimi në kohën e duhur konsiderohen si të dorëzuara në po këtë ditë dhe përgjegjësia bie mbi bankën marrëse.

4. Banka marrëse kontrollon menjëherë çeqet, në ambientet ku zhvillohet seanca e kleringut, për t'u siguruar për rregullshmërinë e tyre. Në rast të konstatimit të parregullsive, pjesëmarrësit nuk i përfshijnë këto çeqe në llogaritjen e rezultatit të seancës.

5. Në rast të konstatimit të parregullsive pas përfundimit të seancës së kleringut, banka marrëse njofton menjëherë bankën dërguese:

- a) për gabimet që gjenden në çeqet e marra; ose
- b) për rastet kur merr çeqe të një banke tjetër marrëse.

6. Banka marrëse kthen çeqet e marra, në seancën pasardhëse të kliringut, por jo më vonë se 3 ditë-punë, në rast të parregullsive të përcaktuara si në pikën 5 të këtij neni ose kur çeqet e marra janë të pambuluara me fonde në lekë.

7. Kthimi i çeqeve në seancën e kleringut konsiderohet i njëjtë me prezantimin e tyre. Banka që kthen çeqet plotëson formularin 2 dhe përshkruan arsyen e kthimit të pjesës së shënimit në formular. Kthimi i çeqeve shoqërohet me kreditimin dhe debitimin e llogarive përkatëse.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në kliring

1. Çdo bankë pjesëmarrëse ka këto të drejta e detyrime:

a) Përgatit me kujdesin e duhur dokumentet që do të paraqiten në seancën e kleringut, në përputhje me dispozitat e nenit 6 të kësaj rregulloreje.

b) Respekton orarin e përcaktuar për fillimin e seancës së kliringut.

c) Paraqitet në çdo seancë kliringu, edhe në rast se nuk ka për të prezantuar çeqe.

d) Verifikon saktësinë e dokumenteve të marra.

e) Njofton bankën dërguese për parregullsi në dokumentacionin e marrë.

f) Kthen çeqet në seancën më të afërt të kliringut.

g) Pranon kthimin e veprimeve në emër të saj në rast se dërgon çeqe në adresë të gabuar.

h) Mban përgjegjësi për çeqet e marra deri në momentin e kleringut apo kthimit të tyre. Banka marrëse mban çeqet në mirëbesim gjatë kohës së kryerjes së verifikimeve të domosdoshme për kthim të tyre, sipas dispozitave të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

i) Mban përgjegjësi për sigurimin e gjendjes së mjaftueshme në llogarinë e saj pranë Bankës së Shqipërisë, për të përballuar pagesat që rezultojnë nga kliringu i çeqeve.

2. Banka e Shqipërisë ka këto kompetenca:

a) Organizon dhe administron shërbimin e kleringut të çeqeve në lekë.

b) Krijon kushte lehtësuese për zhvillimin e seancave të kliringut.

c) Llogarit rezultat neto të seancës për secilin pjesëmarrës.

d) Ekzekuton shlyerjen e instruksionit të shlyerjes neto pas përfundimit të seancës, nëpërmjet debitimit dhe kreditimit të llogarive rrjedhëse që mbajnë pjesëmarrësit në Bankën e Shqipërisë.

e) Në rast ndryshimi të orarit, njofton bankat për këtë ndryshim, jo më vonë se 5 ditë-punë nga data e ndryshimit të orarit.

f) ushtron të gjitha kompetencat dhe të gjitha të drejtat që i njeh ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", për marrjen e sanksioneve ndaj çdo banke e cila vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 11

Përfundimi nga përgjegjësia

1. Banka e Shqipërisë nuk është përgjegjëse për humbjet që pëson një bankë lidhur me pjesëmarrjen e saj në seancën e kleringut, me përjashtim të rasteve kur humbja është pasojë e neglizhencës ose mosdrejtimit të mirë të seancave të kleringut nga Banka e Shqipërisë.

2. Përveç rasteve të parashikuara më lart, pjesëmarrësit në kliring nuk mbajnë përgjegjësi për

dëmet që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, që vijnë si pasojë e gjendjeve të shpallura të jashtëzakonshme, luftrave, grevave, demonstratave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore, për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të tyre, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

1. Ngarkohet Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë dhe pjesëmarrësit e tjerë në seancat e kleringut për zbatimin e kësaj rregulloreje.
2. Ngarkohet Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave me njoftimin e bankave të nivelit të dytë për këtë rregullore.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja “Për organizimin e shërbimit të kleringut në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.87, datë 27.8.1999.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

Formular nr. 1 – Formulari i kërkesës për anëtarësim

Banka _____

K Ë R K E S Ë

Data: _____

Nga : Banka _____

Për : Bankën e Shqipërisë

Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave

Tiranë

Objekti : Anëtarësimi në kleringun ditor të çeqeve në lekë.

1. Pasi u njohëm me rregulloren “Mbi organizimin e kleringut të çeqeve në lekë në Bankën e Shqipërisë”, kërkojmë të anëtarësohemi në shërbimin e kleringut të çeqeve në lekë, të organizuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Gjithashtu, deklarojmë se jemi njohur dhe pranojmë marrëveshjet e lidhura që kanë si objekt veprimtarinë me çeqet në lekë.

3. Ju njoftojmë emrat e përfaqësuesve të autorizuar në kleringun e çeqeve si më poshtë:

Z/Zj _____

Z/Zj _____

Titullari

emër mbiemër, nënshkrimi

Formular nr. 2 – Formulari për dërgimin e çeqeve në lekë në klering

Banka _____

DËRGIMI NË KLERING I ÇEQEVE: ☐ BANKARE ☐ PERSONALE

Data _____

Banka _____ (pranuese)

Për
Bankën _____ (lëshuese)

Nr.	Numri i çekut	Shuma në lekë
	Totali	

Shënim:

Nënshkrimi i autorizuar

Nënshkrimi i autorizuar

Emër, mbiemër, nënshkrimi

Emër, mbiemër, nënshkrimi

Formular nr.3-Formulari i kleringut të çeqeve

Banka _____

Kleringu i çeqeve

☐ BANKARE

☐ PERSONALE

Data _____

Nr. Llog.	Bankat pjesëmarrëse	Nr.	Shuma e sjellë (K)	Shuma e marrë (D)	Shuma neto

Nënshkrimi i përfaqësuesit në klering.

Emër, mbiemër, nënshkrimi

Formular nr.4 – Instruksioni i shlyerjes neto

BANKA E SHQIPËRISË

Kliringu i çeqeve

☐ BANKARE

☐ PERSONALE

Data _____

Nr. Llog.	Bankat pjesëmarrëse	Neto për t'u debituar	Neto për t'u kredituar
	Totali		

Nënshkrimi i drejtuesit të seancës së kliringut

Emër, mbiemër, nënshkrimi